

Kur'ani, xhuz pas xhuzi

Shpjegues i shkurtër i xhuzeve



PËRMBAJTJA

XHUZI 1.....	4
XHUZI 2.....	5
XHUZI 3.....	6
XHUZI 4.....	7
XHUZI 5.....	8
XHUZI 6.....	9
XHUZI 7.....	10
XHUZI 8.....	11
XHUZI 9.....	12
XHUZI 10.....	13
XHUZI 11.....	14
XHUZI 12.....	15
XHUZI 13.....	16
XHUZI 14.....	17
XHUZI 15.....	18
XHUZI 16.....	19
XHUZI 17.....	20
XHUZI 18.....	21
XHUZI 19.....	22
XHUZI 20.....	23
XHUZI 21.....	24
XHUZI 22.....	25
XHUZI 23.....	26
XHUZI 24.....	27
XHUZI 25.....	28
XHUZI 26.....	29
XHUZI 27.....	30
XHUZI 28.....	31
XHUZI 29.....	32
XHUZI 30.....	33

HYRJE

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit.

TË GJITHA LAVDËRIMET I TAKOJNË ALLAHUT, prej Tij ndihmë dhe falje kërkojmë. Kërkojmë mbrojtje tek Allahu nga e keqja e shpirttrave tanë dhe nga veprat tona të këqija. Kë e udhëzon Allahu, kurrë nuk do të jetë i humbur, dhe këdo që Allahu e lë të humbur, askush nuk mund ta udhëzojë. Dëshmoj se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut, Një, i pashembulltë, dhe se Muhamedi është rob dhe i Dërguari i Tij.

Kjo përmbledhje modeste e Kur'anit në 30 nëndarje, të njohura si xhuze është përpiluar për të na shtuar përqëndrimin (*bushun*) në namaz dhe për t'i pasuruar ato gjatë dëgjimit të Kur'anit, veçanërisht në Ramazan ku në shumicën e xhamive muslimanët përpiqen ta lexojnë të tërin gjatë gjithë muajit të shenjtë. Shpresojmë që ky të jetë një inkurajim për ta lexuar së paku një xhuz në ditë, dhe të kapemi edhe më shumë për Kur'an, sa të njihemi si Njerëz të Kur'anit.¹

“Ky është libri që nuk ka dyshim në të (sepse është prej Allahut) është udhëzues për ata që janë të devotshëm.” (Kur'an, 2:2).

¹ Ebu Uameh (Allahu qoftë i kënaqur me të) tha se Pejgamberi (paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të) ka thënë: "*Lexo Kur'anin! Vërtet ai do të vijë në Ditën e Gjykimit si ndërmjetës për shoqëruarit e tij.*" Hadith [Transmeton Muslimi]

XHUZI 1

SURET DHE AJETET ~ 1. El-Fatiha dhe 2. El-Bekare (1- 141)

Xhuzi i parë i Kur'anit përmban suren hapëse, shtatë ajetet e el-Fatiha dhe pjesën e parë të sures më të gjatë, el-Bekare (Lopa). Jo më kot disa prej gjeneratave të hershme të muslimanëve e konsideronin el-Fatiha të jetë 'Nëna e Librit'. Në shtatë ajetet e saj të shkurtra, lavdërohet Allahu, pohohet shkoqur se adhurimi duhet të jetë për Të, të Vetmin, dhe përfundon duke na treguar për rrugën e udhëzimit. Pason pjesa e parë e el-Bekare (Lopa), e cila shpalos natyrën e njerëzimit nëpërmjet tregimit të Ademit dhe largimin e tij nga Xheneti. Sureja vazhdon me ngjarjet e bijëve të israelit (hebrenjve) dhe na jep mësim të rëndësishme nga tregimi i lopës.

Ç'NA MËSON KY XHUZ?

Adhurimi i takon vetëm Allahut dhe vetëm prej Tij duhet kërkuar ndihmë; Allahu e ndan njerëzimin në tre kategori: besimtarë, jobesimtarë ose hipokritë dhe përshkruan karakteristikat e hipokritëve; Tregimi i lopës ka mësim të mrekullueshme: ruhuni nga lëkundjet kur përballeni me urdhrat e Allahut, mos e zvaritini zbatimin e tyre, mos u tallni me to, sepse kjo çon në ngurtësim të zemrave; Kujdes nga rreziku i ndalimit të njerëzve për ta kujtuar Allahun në xhami ose për t'i rrënuar ato; Kush e ndërtoi Xhaminë e Shenjtë, si dhe përse u ndërtua.

XHUZI 2

SURET DHE AJETET ~ 2. *El-Bekare* (142- 252)

Në këtë xhuz, Allahu u përgjigjet hebrenjve të asaj kohe dhe akuzave të tyre kur drejtimi në namaz u ndryshua nga xhamia el-Aksa në Jerusalem kah Qabeja në Mekë. Ç'është e rëndësishme, Allahu e përmbyll çështjen duke vënë në pah se pastrimi i shpirtit të njeriut është më i rëndësishëm sesa ndonjë drejtim i veçantë në namaz. Xhuzi gjithashtu shpalos urtësinë e Allahut për një numër çështjesh: trashëgimia, martesë, haxhi; ku spikatet agjërimi – e vetmja sure në Kur'an ku detajohet ky adhurim i madh. Përgjatë gjithë këtij xhuzi, madje dhe në mesin e çështjeve më të hollësishme, Allahu prore na përkujton domosdoshmërinë e mbajtjes së devtotshmërisë (*takva*) – që njeriu të jetë i vetëdijshëm për Allahun në të gjitha punët e tij.

Ç'NA MËSON KY XHUZ?

Obligueshmëria e agjërit, rregullat e tij dhe çështjet e tjera të ndërlidhura. Vetëm në këtë sure jepen detajet e agjërit, kështu që mendojeni mirë këtë! Rregullat lidhur me haxhin, martesën, shkurorëzimin, gjdhënien, etj., ku në mesin e tyre Allahu thekson edhe rëndësinë e devotshmërisë (*takva*); Historia e Xhalutit dhe e një populli të fuqishëm që nuk u mposht dot nga numra të mëdhenjë luftëtarësh apo forca të mëdha, por ngadhnjeu nëpërmjet besimit, durimit dhe qëndrueshmërisë.

XHUZI 3

SURET DHE AJETET ~ *El-Bekare (253 –fund), 3. Ali Imran (1-92)*

Ky xhuz sjell suren më të gjatë të Kur'anit i cili përmban ajetin më të madh – ajeti el-Kursi (282). Ky ajet mjaft domethënës është ajeti më i madh në Kur'an ku përmes memorizimit, kuptimit dhe recitimit të tij, adhuresit përfitojnë shumë shpërblime. El-Bekare përfundon me një numër rregullash që tregojnë se bamirësia është themeli i një ekonomie islame, si dhe ndalesa e Allahut ndaj kamatës. Allahu shpall se ata që përfshihen në të është sikur t'i kenë shpallur luftë Atij. Tri ajetet e fundit të kësaj sureje janë lutje për kërkimfalje dhe kërkim mbrojtje nga Allahu. Xhuzi vazhdon me suren e radhës, Ali Imran (Familja e Imranit) që ndër të tjera, flet për historinë e Isait – shembull i jashtëzakonshëm që shpalos mohimin dhe keqinterpretimin që njeriu i bëri mesazhit të Allahut.

Ç'NA MËSON KY XHUZ?

Ajeti më i madh në Kur'an: ajeti el-Kursi, analizojeni me kujdes, memorizojeni dhe sigurohuni që ta keni kuptuar saktë atë; Kamata është luftë kundër Allahut dhe të Dërguarit të Tij; Se Kurani është kriter që ndan të vërtetën nga gënjeshtra, dhe se Allahu vetëm Islamit do ta pranojë si fe të vërtetë; Ngjarja e nënës së Merjemes tregon se si qëllimi i drejtë dhe i sinqertë ndikon pozitivisht te fëmiu; Musai, Isai, Muhamedi (paqja qoftë mbi ta), të gjithë besonin në Teuhid (Njëshmëri të Zotit) dhe paralajmëronin kundër shirkut (idhujtarisë); Na jep mësim të rëndësishëm kur bëhet fjalë për kritikën që i bëhen një shoqërie ose një populli: është gabim të përgjithësohet.

XHUZI 4

SURET DHE AJETET ~ 3. *Ali Imran* (92- fund), 4. *En-Nisa* (1- 23)

Pas thirrjes që Allahu u kishte bërë të krishterëve në pjesën paraprake të sures Ali Imran dhe hebrenjve në suren e mëparshme, Allahu tani u drejtohet muslimanëve.

Fillon me thirrje ndaj komunitetit musliman të qëndrojë i bashkuar, duke u kapur fort për litarin e Allahut. Pastaj flet për betejën në Bedër dhe Uhud, duke treguar hollësisht arsyet pse në Bedër u korr fitore përkundër të gjitha gjasave, kurse në Uhud ndodhi e kundërta. Allahu e përmbyll duke na përkujtuar se Premtimi i Tij është i sigurt dhe se ne duhet të kemi durim dhe devotshmëri (*takva*). Në këtë xhuz fillon poashtu edhe sureja En-Nisa (Gratë), e titulluar kështu pasi shpeshherë u referohet grave dhe urdhëresave që kanë të bëjnë me to. Kjo sure është e një rëndësie të veçantë, u shpall pas mposhtjes në Uhud dhe në të shpalosen disa nga pasojat e paevitueshme; flitet për të vejat, jetimët dhe ndarjen e drejtë të pasurisë.

Ç'NA MËSON KY XHUZ?

Rëndësia e të kapurit fort për litarin e Allahut dhe rëndësia e unitetit dhe jo përçarjes; Statusi i lartë i umetit musliman në bazë të urdhërimit të tyre në të mirë dhe ndalimit nga e keqja; Të këqijat si pasojë e mosbindjes, siç na tregohet me shembullin e Betejës në Uhud; Cilësitë e robërve të drejtë të Allahut. Reflektoni dhe përpiquni maksimalisht të jeni prej tyre! I Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të) recitonte ajetet e fundit të sures Al Imran pas zgjimit nga gjumi – reflekto rreth tyre me kujdes; Sureja En-Nisa përqendrohet në të drejtat e të dobëtëve dhe të mëkëmburve, jetimëve, grave, të atyre që ishin të shtypur dhe të paafte për të migruar.

XHUZI 5

Suret dhe ajetet ~ 4. En-Nisa (24– 147)

Ky xhuz vazhdon me suren En-Nisa, e cila mori këtë emër ngaqë aty përmenden dispozitat për gratë dhe jetën familjare në tërësi. Sureja vazhdon të shpjegojë legjislacionin praktik nga Allahu që ishte i rëndësishëm për komunitetin e asokohshëm musliman, i cili që po e rimerrte veten pas humbjes të jetëve në Betejën e Uhudit. Në përmbyllje të çerekut të fundit të xhuzit, Allahu thotë se nuk ka besuar ai i cili beson vetëm Atë pa besuar në të gjithë të dërguarit e Tij – përgënjeshtër ndaj hebrenjve, të cilët e refuzuan Muhamedin (paqja qoftë mbi të), dhe të krishterëve të cilët e kishin shtrembëruar mesazhin e Isait.

Ç'NA MËSON KY XHUZ?

Marrëdhëniet familjare, në veçanti marrëdhëniet mes burrit dhe gruas dhe se si duhet zgjidhur mosmarrëveshjet bashkëshortore; Urdhërin për bindje ndaj Allahut, të Dërguarit të Tij dhe atyre që janë caktuar në pushtet dhe se për çdo mosmarrëveshje duhet t'i referohemi Kur'anit dhe Sunetit (mësimeve të Pejgamberit Muhamed); Kërkimi i gjykimeve me ligje tjera përveç ligjit të Allahut është tipar hipokritësh; ç'është e vërteta, ata bëjnë çmos për ta larguar njeriun nga ligji i Allahut; Udhëzime praktike ligjore; shkurtimi i namazeve gjatë udhëtimit; përshkrimi i namazit në kohë të frikës; ligji martesor; si të merremi me mosmarrëveshje; rëndësia e drejtësisë dhe rregullat që kanë të bëjnë me ndarjen e bashkshortëve – duke ia kujtuar prore muslimanit të jetë i vetëdijshtë për Allahun dhe t'ia ketë frikën Atij; Jepen detaje se si hipokritët bashkohen me armiqtë e Allahut, vihet në pah përtacia e tyre në adhurim, dhe përfundimi i tyre në ahiret (botën tjetër).

XHUZI 6

SURET DHE AJETET ~ 4. *En-Nisa* (148- fund) dhe 5. *El-Maide* (1- 81)

Pasi i përgënjeshtroi ithtarët e Librit dhe besimet e tyre në lidhje me Isain dhe nënën e tij, Merjemen, Allahu tani shpall se si kishin rënë në lajthitje ithtarët e Librit. Ai na tregon se si Isai u ngrit tek Allahu dhe nuk u kryqëzua në kryq dhe se mesazhi i tij që mu sikurse ai Pejgamberit Muhamed (paqja qoftë mbi ta). Ajetet kuranore që flasin për marrëdhëniet e Pejgamberëve me Allahun na japin mësim të dobishme. Ajeti i fundit flet për ligjin e trashëgimisë, duke dhënë shembuj konkretë se udhëzimet shoqërore nuk mund të ndahen nga besimi individual. Xhuzi vazhdon me suren e pestë të Kur'anit, suren El-Maide (Sofra e Shtruar). Sureja është emërtuar sipas ushqimit të shtruar që u kërkuar nga pasuesit e Isait – dhe ajeti i tij kurorëzues (3) është fjala e Allahut se Islami u përsos dhe u përmbush Mirësia e Tij ndaj nesh.

Ç'NA MËSON KY XHUZ?

Një pjesë e madhe e el-Maide, një nga suret e fundit që do të shpallej, merret me ligjin e kontratës dhe premtimet që japim në jetën tonë; El-Maide përmend 18 rregulla dhe dispozita që nuk gjenden tjetërkund në Kur'an; Sureja fillon me detajimin e ushqimeve të ndaluara dhe të atyre që janë të lejuara; Ajeti në lidhje me abdesin i cili përmend obligimet e tij dhe të guslit (pastrimit ritual të tërë trupit); Dëshmia duhet të jetë për hir të Allahut dhe duhet gjithmonë të jemi të drejtë edhe ndaj njerëzve që na urrejnë; Vendimi ndaj atij që nuk gjykon me ligje të Allahut; Përgënjeshtrohet besimi i të krishterëve rreth Isait (paqja qoftë mbi të), dhe atyre u jepet mundësia për t'u penduar.

XHUZI 7

SURET DHE AJETET 5. *El-Maide* (82-fund), 6. *El-En'am* (1-110)

Në këtë xhuz, Allahu përmbyll kapitullin e el-Maide (Sofra e Shtruar) me një sërë vendimesh mbi dhënien e betimit, bixhazin, gjuetinë dhe ndalimin e alkoolit. Një temë e ngjashme përshkohet gjatë kësaj sureje, ndërsa ajetet e fundit të sures kanë të bëjnë me Krishterimin, mrekullitë e Isait dhe ngjarja nga e cila vet sureja e merr emrin. Sureja mbaron duke dhënë dëshmi se Isai kurrë nuk ka pohuar hyjninë për vete. Xhuzi gjithashtu përmban pjesën e parë të sures së 6 të Kuranit, el-En'am (Bagëtitë). Kjo sure emërtohet sipas bestytive të arabëve para-islam, por që në esencë është një argument shumëdimensional kundër tendencës njerëzore për t'i përshkruar ortak Allahut, qoftë drejtpërdrejt apo tërthorazi.

Ç'NA MËSON KY XHUZ?

Për ithtarët e librit që janë më të afërt me ne dhe ata që janë më të largët prej nesh; Rregullat dhe dispozitat për dhënien e betimit, alkoolin dhe bixhazin, gjuetinë gjatë *ihram*-it (kur muslimanët fillojnë udhëtimin për në umre), testamentin, dhënien e dëshmisë; Biseda mes Allahut dhe Isait (paqja qoftë mbi të) që hedh poshtë çdo pretendim për hyjnëzim të tij; Teuhidi, Ringjallja dhe Profetësia në suren el-En'am; Ngjarja e Ibrahimit (paqja qoftë mbi të) dhe babait të tij, debati i tij me popullin e tij dhe jepen hollësi mbi pasardhësit e tij; Imani (Besimi) shtohet duke medituuar rreth krijesave, sepse kjo të shpie drejt madhërimit të Krijuesit të tyre - Allahut.

XHUZI 8

SURET DHE AJETET ~ 6.*El-En'am* (111- fund), 7. *El- A'raf* (1- 87)

Allahu përmbyll suren El-En'am (Bagëtitë) duke qëndruar në temën e Teuhidit. Ajetet në këtë pjesë të sures gjithashtu përmbajnë hollësi rreth ushqimit të ndaluar dhe atij të lejuar për muslimanët. Allahu paralajmëron për vendimin e Tij për ata që nuk ndjekin rrugën e Teuhidit, gjykim ky i cili vërtetë do të ndodhë. Si ilustrim, Ai na shpjegon arsyet e shkatërrimit të qyteteve të mëhershme. Sureja përmbillet me urdhërin drejt Pejgamberit (paqja qoftë mbi të) që të thotë "Thuaj: "namazi im, kurhani im, jeta ime dhe vdekja ime janë thjesht për Allahun, Zotin e botëve. Ai nuk ka shok (nuk adhuroj tjetër)." Sureja në vazhdim, El A'raf sjell më në hollësi ngjarjen e Ademit dhe Pejgamberëve që erdhën pas tij – është një sure që na paralajmëron për armiqtë tanë, për shejtanin dhe të tjerët, dhe na tregon se si arrihet shpëtimi përmes udhëzimit pejgamberik.

Ç'NA MËSON KY XHUZ?

Ta adhurojmë vetëm Allahun dhe të ndjekim rrugën e Tij që na mëson për unitet dhe jo përçarje; Bestytnitë e arabëve para-islamik në lidhje me bagëtitë dhe përgënjeshttrimin që e bëri Allahu për to; Ngjarja e Ademit dhe krijimi i Havës, mashtrimi i tyre nga shejtani, armiku i përhershëm i njerëzimit; Të kemi kujdes nga armiqtë e Allahut dhe t'i pasojmë shpalljet dhe pejgamberët – në të vërtetë, Xhehenemi është vendbanimi përfundimtar i armiqve të Allahut; Tregimet për Nuhun dhe Përmbytjen e Madhe, Hudin, Salihun, Lutin dhe Shuajbin; Të gjithë këta pejgamberë rezistuan, por në fund, fitorja u takoi atyre dhe e keqja u gjunjësua përfundimisht; plani i Allahut nuk dështon kurrë.

XHUZI 9

SURET DHE AJETET ~ 7. *El-A'raf* (88-fund), 8. *El-Enfal* (1-80)

Në ajetet tjera të el-A'raf, Allahu na tregon me shumë hollësi historinë e Musait (paqja qoftë mbi të) dhe luftën e tij me armikun e madh të Allahut, Faraonin. Tutje, na tregohet përvoja e Musait me bijtë e israilit nga të cilat nxirren shumë mësim të rëndësishme për umetin musliman dhe për nënshtrimin tonë ndaj mesazhit profetik të Pejgamberit Muhamed (paqja qoftë mbi të). Sureja përmbillet duke folur për Kura'nin dhe rolin e të Dërguarit të Allahut (paqja qoftë mbi të) – një njeri i devotshëm që nuk ndjeu aspak mendjemadhësi për ta adhuruar Allahun. Krejt i kundërt nga armiqtë që përmenden përgjatë sures. Xhuzi vazhdon me suren el-Enfal (Plaça e luftës) që u shpall fill pas Betejës në Bedër. Mësimi i nxjerrë nga kjo betejë: virtytet që duhet poseduar për të luftuar në rrugën e Allahut, fitoren, përkundër gjasave minimale, mëshirën dhe trajtimin e të tjerëve.

Ç'NA MËSON KY XHUZ?

Gjersa konflikti mes Musait dhe Faraonit sa shkonte e thellohej, kjo vetëm sa e nxiste edhe më shumë Musain (paqja qoftë mbi të) që ta shtonte varësinë ndaj Allahut; Pasi erdhën kohëra më të vështira, Musai i kërkoi popullit të tij që t'i ktheheshin Allahut dhe t'i luteshin për ndihmë Atij, të ishin të duruar, dhe ua përkujtoi atyre se e gjithë Toka i takon Allahut dhe se fundi i mirë u takon të devotshmëve; Pëmendja e banorëve të qytetit pranë detit që mëkatuan në Sabbath, dhe përfundimi i atyre që me mashtime nuk përfillën ligjet e Allahut; Mëshira e Allahut përfshin gjithçka dhe se Ai do ta mëshirojë veçanërisht një grup robërish të Tij; Reflektoni mirë cilësitë e tyre, ndoshta e gjeni veten në mesin e tyre; Fillimi i krijimit dhe përgënjeshtrimi se mund të sjell dobi ndonjë besim a adhurim tjetër përveç Allahut; Betejen në Bedër dhe dispozitat rreth plaçkës së luftës, duke na sjell ndërmend diçka më të vlefshme, devotshmërinë (*takva*) si dhe mbajtjen e lidhjeve farefisnore.

XHUZI 10

SURET DHE AJETET ~ 8.*El-Enfal* (81-fund), 9. *Et-Teube* (1- 92)

Dhjetë ajetet e sures El-Enfal (Plaça e luftës) ua përkujton besimtarëve se fitorja në betejë nuk varet nga numri i madh apo nga fuqia ushtarake, por nga qëndrueshmëria në besim dhe durim, temë kjo e përsëritur gjatë gjithë Kuranit. Këtu gjithashtu trajtohet çështja e robërve të luftës të zë në gjatë Betejës së Bedrit, virtytet e atyre që luftuan në rrugën e Allahut dhe rëndësia e besimtarëve për ta mbrojtur njëri-tjetrin. Sureja tjetër në këtë xhuz është et-Teube (Pendimi), e vetmja sure në Kur'an që nuk fillon me Bismilah – kjo për arsye se konsiderohet se është një vazhdim i kapitullit të mëparshëm që merret me çështje të ngjashme, siç janë moralet e besimtarëve dhe jobesimtarëve. Sureja u shpall në vitin 9 Hixhri, vit në të cilin gjithashtu shpallet fundi i idhujtarisë në Arabi.

Ç'NA MËSON KY XHUZ?

Vazhdon tema për Betejen në Bedër dhe ëndrrën e Pejgamberit (paqja qoftë mbi të); Thirrje që përmban gjashtë këshilla që shpiejnë në fitore; El-Enfal përmbyllet duke na përkujtuar se vëllazëria është ajo që e bashkon botën muslimane; Et-Teube fillon me përcaktimin e kufijëve të marrëveshjes midis të Dërguarit të Allahut dhe idhujtarëve; Përmendet kalendari islam dhe shpjegohet rëndësia tejet e madhe e muajve të shenjtë; Muslimanët inkurajohen t'i përgjigjen thirrjes në rrugën e Allahut, ndërsa kritikohen rëndë hipokritët dhe të gjithë ata që nuk i përgjigjen thirrjes pa justifikim të pranuar; Përmenden cilësitë e hipokritëve dhe ato të besimtarëve, me premtimet gjegjëse të Allahut për të dyja palët; Pejgamberit (paqja qoftë mbi të) i është ndaluar të kërkojë ndihmë nga hipokritët në kohën e luftës. Gjithashtu, i është ndaluar të kërkojë falje për ta ose të lutet për ta;

XHUZI 11

SURET DHE AJETET ~ 9.Et- Teube (93- fund), 10. Junus, 11. Hud (1- 5)

Xhuzi fillon me pjesën e fundit të sures Et-Teube (Pendimi) ku Allahu vazhdon të përshkruaj moralet e të drejtëve. Allahu vërteton se kënaqësia e Tij është me të drejtët që shpenzojnë për hir të Allahut (vepër kjo që e pastron njeriun) dhe me ata që bëjnë vepra të mira. Ai na kujton se çdo sure në Kur'an e ngrit dhe e forcon besimtarin. Allahu e përfundon këtë kapitull duke na treguar për moralin e lartë të Pejgamberit tonë (paqja qoftë mbi të) dhe sa rëndë e përjetoi i Dërguari ynë faktin se do të vuajmë në botën tjetër. Tutje, në këtë xhuz është e tërë sureja Junus, e cila thekson fuqinë e Allahut, vërtetësinë e Kur'anit dhe fundin e keqbërësve. Flitet për Teuhidin (Njëshmërinë e Zotit), shfaqjen e Allahut para njerëzve, mohimin ndaj Pejgamberëve dhe mirësive hyjnore të Allahut.

Ç'NA MËSON KY XHUZ?

Përmenden cilësitë e mira dhe të këqija të arabëve, pastaj flitet për muhaxherët (ata që u shpërngulën nga Meka) dhe ensarët (Populli i Medinës); Mesxhidi ed-Dirar është tema e ardhshme, gjithashtu theksohen synimet e këqija të atyre që e ndërtuan atë. Kjo ishte arsyeja pse të Dërguarit të Allahut nuk i lejohej të falej atje. Poashtu janë dhënë hollësi rreth mesxhudit në të cilin lejohej të falej namazi; Cilësitë e atyre që kanë dhanë jetët e tyre për hir të Allahut; Pejgamberit dhe besimtarëve u ndalohet të kërkojnë falje për idhujtarët; Fundi i sures et-Teube trajton marrëdhënien e njeriut me Kur'anin dhe reagimet e ndryshme të tyre karshi tij; Sureja Junus përmbledh shenjat e krijimit të Allahut dhe të ngjashme që tregojnë për ekzistencën dhe madhështinë e Allahut; Idhujtarët u sfiduan me këtë Kur'an; Kush janë evliatë? Analizo me kujdes ajetet 10:62-64, ndoshta edhe ti mund të jesh njëri nga ta; Na sillet ndërmend historia e Nuhut, e pasuar nga historia e Musait dhe Faraonit. Momentet e fundit të Faraonit para se të mbytej në det shërbejnë si përkujtim për të gjithë ne; Allahu e urdhëron Pejgamberin të qëndrojë i palëkundur në fe dhe të zbatojë shpalljen derisa të vijë urdhëri i Tij.

XHUZI 12

SURET DHE AJETET ~ 11.Hud (6- fund), 12.Jusuf (1-52)

Xhuzi i 12-të në Kur'an përmban shumicën e surës Hud (pesë ajetet e para janë në xhuzin e mëparshëm) si dhe gjysmën e sures Jusuf, rrëfimet më të mira. Sureja Hud u shpall gjatë vitit të pikëllimit, një periudhë kur Pejgamberi (paqja qoftë mbi të) humbi gruan dhe shoqëruesen e tij, Hatixhen, gjithashtu edhe xhaxhain e tij, Ebu Talibin, i cili e kishte mbrojtur atë. Për pasojë, jeta e tij dhe e komunitetit të ri musliman u bë shumë e vështirë. Kjo sure ngushëllon të Dërguarin dhe pasuesit e tij përmes ngjarjeve të Pejgamberëve të mëparshëm, duke theksuar se si ata vepruan ndaj talljeve, armiqësisë dhe përndjekjes. Sureja e mëparshme theksoi mëshirën e Allahut për krijesat e tij, ndërsa kjo sure thekson drejtësinë e Allahut për krijesat e tij. Ky xhuz gjithashtu fillon me historinë e Jusufit. Kjo sure sillet rreth idesë se vetëm Allahu i drejton punët e njeriut dhe se gjykimi mbetet tek Ai. Na tregohen sprovat e Jusufit, tendosja për shkak të izolimit me të cilën përballet, kthimi në robëri në një vend të huaj, burgosja dhe në fund vjen ndryshimi i fatit të tij për shkak të durimit të tij. Sureja është e veçantë sepse tregon plotësisht ngjarjen e Jusufit, ndërsa në suret tjera gjejmë pjesë të ndryshme nga jeta e Pejgamberëve. Shumë paralele mund të tërhiqen nga tregimi i Jusufit me atë të Pejgamberit Muhamed (paqja qoftë mbi ta), prej nga nxirren mësimet që do të na shërbenin në jetën tonë të përditshme.

Ç'NA MËSON KY XHUZ?

Allahu sfidon idhujtarët me Kur'an; Biseda mes Nuhit dhe djalit të tij tregon se dashuria e Allahut është më e madhe se çdo dashuri tjetër; Historia e Hudit nxjerr në pah se kërkimfalja është mjet për të korrur fitore, në kuptimin literal dhe atë figurativ të kësaj fjale; Përsëritja e vuajtjeve që të dërguarit dhe pejgamberët përjetuan gjatë thirrjes në rrugën e Allahut; Ngjarja e Shuajbit tregon se sa kujdes i kushton Islami tregtisë dhe rëndësisë e të qenët shumë i vetëdijshëm për Allahun gjatë tregtisë; Sureja Jusuf flet për zilinë e vëllezërve të tij dhe për sprovën e bukurisë; Është sinqeriteti që e largon një person nga kryerja e veprave të këqija dhe të shthurura; Daveti (thirrja në Islam) duhet bërë në çdo kohë, madje edhe kur njeriu burgoset.

XHUZI 13

SURET DHE AJETET ~ 12. *Jusuf (53- fund)*, 13. *Er-Rra'd*, 14. *Ibrahim (1-52)*

Ky xhuz fillon me pjesën tjetër të historisë së Jusufit, përfshirë këtu takimin e tij me mbretin, shfajësimin e vazhdueshëm dhe arritjen e lartë. Nga një djalosh i ri që e hodhën në bunar, Jusufi e gjen veten në një pozitë të lartë gjatë një krize në Egjiptin e asokohshëm. Është kjo koha kur Jusufi bashkohet me familjen e tij, shumë vite pasi që vëllezërit e tij komplotuan ta linin atë në pus. Ngjarja e Jusufit është një shembull madhështor që tregon se si durimi dhe qëndrueshmëria në fe mund t'i tejkalojnë madje edhe komplotistët më të mëdhënj. Xhuzi vazhdon me suren er-Rra'd me temat si Njëshmëria e Allahut, feja, shpallja dhe ringjallja. Sureja shquhet me përshkrimin prekës të Fuqisë dhe Urtësisë së Allahut. Xhuzi përmbillet me suren Ibrahim, që shpjegon se si shpallja e Allahut do të mbizotëroj, pavarësisht planeve të njerëzve kundër saj. Mesazhi hyjnor dhe begatitë e Allahut janë temat kryesore të kësaj sureje. Por ashtu si edhe suret tjera mekase, ajo ngërthen edhe tema tjera, siç janë besimi, shpallja, Njëshmëria e Allahut, ringjallja dhe Dita e Gjykimit.

Ç'NA MËSON KY XHUZ?

Shembulli i Jakubit na jep mësim për durimin dhe frytet që dalin prej tij; Durimi dhe devotshmëria ishin dy tipare kryesore të Jusufit që e ngriten atë në pushtet dhe në aspektin shpirtëror; Sureja Jusuf përfundon duke përmendur shenjat e Allahut në krijim, të dërguarit e Tij, vilen mësim nga ngjarjet që Kur'ani sjell; Allahu na sjell shembëlltyra për Kur'anin që tregojnë madhësitinë e Tij në suren Er-Ra'd; Dhjetë këshilla përmenden dhe kushdo që i ndjek ato do të ketë shpërblim Xhennetin; Sureja Ibrahim fillon me ngjarjen e Musait dhe rrëfimet mbi pejgamberët tjerë që ishin dërguar tek popujt e tyre. Vihet në pah durimi dhe mbështetja e tyre tek Allahu; Një skenë nga Dita e Gjykimit ku shejtani shfajësohet para pasuesëve të tij. Pra, kini kujdes të mos josheni nga i mallkuari! Jepet një shembull për fjalën e mirë dhe për fjalën e keqe, pastaj flitet për begatitë e Allahut. A jeni ju mirënjohës? Sureja Ibrahim mbaron duke përmendur destinacionin e fundit të keqbërësve dhe kriminelëve në një ditë kur Toka do të zëvendësohet me një Tokë tjetër poashtu edhe Qiejt.

XHUZI 14

SURET DHE AJETET ~ 15. *El-Hixhr*, 16. *En-Nahl*

Në këtë xhuz përfshihen dy sure El Hixhr (Lugina e gurtë) dhe En-Nahl (Bleta). E para u shpall në një kohë kur përndjeka ndaj Pejgamberit dhe pasuesve të tij kishte arritur kulminacionin dhe Islami po bënte pak përparim në krahasim me kundërshtimin dhe rezistencën arabe. Allahu i paralajmëron idhujtarët arabë për fatin e popujve të mëhershëm, të cilët ngjashëm u kundërviheshin Pejgamberëve të tyre. Me anë të paralajmërimit të mëtejme, Allahu thekson se si shejtani ngulmon për t'i prishur njerëzit, ndërsa Pejgamberi ngushëllohet duke e udhëzuar që të kapet fort pas të vërtetës, të jetë i durueshëm dhe i palëkundur. Krejt në fund, e Vërteta është një çështje e mbrojtur nga Allahu. Sureja e Bletës merr emrin nga përmendja e bletës dhe krijimi i saj i mrekullueshëm në ajetin 68. Sureja tregon poashtu begatitë e pafundme të Allahut dhe shumë shenja të dukshme në krijesat e Tij.

Ç'NA MËSON KY XHUZ?

Allahu e ngushëllon të Dërguarin (paqja qoftë mbi të) duke i rrëfyer ngjarjet e disa Pejgamberëve që kishin qenë para tij. Tregimet e Ibrahimit, Lutit dhe Popullit të El-Hixhrit; El-Hixhr përfundon duke këshilluar ata të cilëve zemrat e tyre u janë ngurtësuar për ta kujtuar Allahun dhe për ta lavdëruar Atë; En-Nahl quhet gjithashtu Sureja e Begatshme, reflektoni me kujdes dhe jinni mirënjohës ndaj Atij që u ka dhuruar ato; Jepen shumë dëshmi që tregojnë se vetëm Allahu meriton të adhurohet; Pasi që flitet për begatitë e Tij të shumta, Allahu rrëfen edhe historinë e qytetit që populli i tij ishte mosmirënjohës për begatitë e Allahut dhe se si u erdhë fundi i tyre; Sureja mbaron duke inkurajuar njeriun që t'i lutet Allahut me urtësi e fjalë të mira dhe të jetë i durueshëm përballë humbjes a shtypjes që mund t'i ndodh atij.

XHUZI 15

SURET DHE AJETET ~ 17.El-Isra / *Bijtë e Israelit*, 18. El-Kehf (1-74)

Xhuzi fillon me suren El-Isra (Udhëtimi i natës). Sureja emërtohet sipas ngjarjes së mrekullueshme në të cilën Pejgamberi (paqja qoftë mbi të) udhëtoi nga Meka në Jerusalem dhe pastaj nëpër Qiej brenda një nate të vetme; kjo përmendet në ajetin hyrës të sures. Pasojnë ajetet që flasin mbi natyrën e Mesazhit të Allahut dhe rolin e Pejgamberëve. Në një shembull tjetër, prore me një stil të shkëlqyeshëm gjuhësor të Kur'anit, sureja fillon duke madhëruar Allahun dhe përfundon duke e lavdëruar Atë, gjë që përshkohet me ndjenjën se e tërë sureja është një lavdërim. Në këtë sure kemi ngjarjen e bijëve të israelit rreth xhamisë el-Aksa, destinacionin e Pejgamberit gjatë Udhëtimit të Natës, ajo trajton gjithashtu aspektet e sjelljes individuale dhe shoqërore. Sureja e radhës është El-Kehf (Shpella), e cila merr emrin sipas Djelmoshave të Shpellës që fillon nga ajeti 9 e tutje, kurse temë qendrore është ajo e pastrimit të besimit prej të gjitha devijimeve dhe bestytive; ajetet theksojnë shpërblimin e besimit të vërtetë dhe të singertë në Allahun dhe nënshtrimin absolut ndaj Tij. Ajetet gjithashtu vënë në dukje se është besimi i vërtetë ai i cili është kandar për gjykimin e besimeve dhe vlerave.

Ç'NA MËSON KY XHUZ?

El-Isra fillon me ajetet që flasin për xhaminë el-Aksa, se si arritën bijtë e israelit atje dhe devijimin e tyre të mëvonshëm; Sureja përmban 20 këshilla që kanë të bëjnë me moralin, sjelljen dhe shoqërinë; Allahu i trajton argumentet e shejtanit pas krijimit të Ademit; Pejgamberi (paqja qoftë mbi të) këshillohet të mos varet nga idhujtarët por të mbështetet tek Allahu; El-Kehf merret me katër prova: fe, pasuri, dituri dhe fuqi. Në fe: ngjarja e Djelmoshave të Shpellës e cila është mësim për çdo njeri që ia mësyen shtegut të së vërtetës. Në pasuri: ngjarja e kopshtit dhe dy burrave, njëri i pasur që mohoi ringjalljen dhe tjetri i varfër që besoi në Allahun dhe Ditën e Gjykit. Në dituri: ngjarja e Musait me Hidrin na jep mësim mbi sjelljen morale, aspiratat e larta dhe urdhërimin për të mirën dhe ndalimin nga e keqja. Në fuqi: tregimi i Dhul Karnejnit me jexhuxhët dhe mexhuxhët – në xhuzin e radhës.

XHUZI 16

SURET DHE AJETET ~ 18. *El-Kehf* (75- fund), 19. *Merjem*, 20. *Ta-Ha*

Sureja el-Kehf (Shpella) përfundon në këtë xhuz ku Allahu përmbyll ngjarjen e Musait dhe Hidrit dhe më pas përmend atë të Dhul Karnejnit. Historia e Musait dhe Hidrit na mëson shumë paradokse të jetës që mund të kuptohen vetëm përmes durimit dhe diturisë, ky është një mësim të cilin madje edhe Musai e kishte të vështirë ta pranonte. Sureja tjetër në këtë xhuz quhet Merjem, ku flitet për më të devotshmen ndër të devotshmet, nënën e Isait. Temë qendrore e sures është Teuhidi (Njëshmëria e Allahut), e cila na shpaloset nëpërmjet disa tregimeve të Mirësive të Allahut dhënë Pejgambëve të Tij. Flitet edhe për Ditën e Gjykimit ku përmenden disa argumente kundër atyre që mohojnë ringjalljen, duke përforsuar kështu temën qendrore të kësaj sureje. Sureja e fundit e këtij xhuzi është Ta-Ha. Kjo merret me natyrën e shpalljes dhënë Pejgamberit; fillon dhe përfundon duke iu drejtuar atij, duke përshkruar kështu misionin dhe detyrat e tij. Allahu na jep një ndjenjë sigurie me Vullnetin e Tij Hyjnor duke na treguar se si i mbështeti, dhe u ndihmoi Pejgamberëve të Tij.

Ç'NA MËSON KY XHUZ?

Pjesa e mbetur e mësimi mbi fuqinë dhe pushtetin vije nëpërmjet tregimit të Dhul Karnejnit; El-Kehf përfundon me një skenar të Ditës së Fundit ku përshkruhet fundi i besimtarëve dhe ai i jobesimtarëve; Në kapitullin e Merjemes, fjala rahma (mëshirë) ose derivati i saj përmendet 16 herë; Lexoj me kujdes ajetet ku përmendet kjo fjalë, ashtu që edhe ti të mëshirohesh; Hollësitë e ngjarjeve të Ibrahimit, Zekarijas dhe Isait. Shih se si Ibrahim vazhdoi t'i drejtohej të atit me durim dhe respekt; Sureja Ta-Ha përshkruan magjistarët të cilët u konfrontuan me Musain. Në fillim qenë jobesimtarë, por më pas u bënë besimtarë të devotshëm deri në vdekje; këto ajete na thonë se sa shpejt besimi i vërtetë zë rrënjë në zemër; Mirësia e Allahut ndaj bijëve të israelit i nxorri ata nga toka në të cilën ata shtypeshin dhe bëri që Faraoni të fundosej me forcat e tij; Gjendja e atyre që largohen nga e vërteta rreth Ditës së Fundit dhe disa nga tmerret e asaj Dite; Njerëzimi paralajmërohet për armiqësinë e shejtanit, dhe kjo ilustron në tregimin e Ademit; Sureja përfundon duke ngushëlluar Pejgamberin dhe duke e urdhëruar atë që të qëndrojë i palëkundur dhe i përkushtuar në fe.

XHUZI 17

SURET DHE AJETET ~ 21. *El-Enbija*, 22. *El-Haxh*

Në këtë xhuz përfshihen dy sure të tëra: El-Enbija (Pejgamberët) dhe El-Haxh. Sureja El-Enbija, e cila iu zbrit Pejgamberit në Mekë, merret me çështjet e besimit duke u përqendruar në tri fusha: Teuhid (Njëshmëria e Allahut), shpalljen e Allahut, dhe ringjallje. Duke sjell sërish ngjarjen e Ibrahimit si një shembull udhëzues, kjo sure na mëson se e liga do të mundohet të na largojë nga rruga e virtytit të lartë, por për ata që përpiqen në atë rrugë, është vetëm Allahu që do t'i ndihmoj ata ta arrijnë atë. Vëmendja e lexuesit tërhiqet kah ligjet e mrekullueshme që rregullojnë krijimet e Allahut, të cilat dëshmojnë njëherësh Njëshmërinë e Tij; mesazhi hyjnor dhe besimi pasqyrohet më tej në jetën e të gjithë Pejgamberëve. Sureja mbyllet duke na kujtuar Ditën e Fundit. Në suren vijuese, mësojmë më shumë rreth Teuhidit, ringjalljes, mohimit të besimeve pagane dhe argumenteve të Allahut në krijimet e Tij. Besimtarët udhëzohen të luftojnë në rrugën e Allahut nëse e mbrojnë vetëm të vërtetën. Sureja prekë tema që forcojnë besimin, devotshmërinë dhe përluljen ndaj Allahut.

Ç'NA MËSON KY XHUZ?

El-Enbija fillon duke e paralajmëruar njeriun për ringjallje, pohon se ajo vërtetë do të ndodhë dhe se ajo Ditë nuk është largë. A jeni përgatitur për Të? Ngrihen dëshmitë e Teuhidit duke përdorur argumente racionale dhe empirike; Historinë e Ibrahimit kur thyen idhujt, që është mësim i madh për mbështetjen e palëkundur në Allahun (*tevekul*); Sureja mbaron me thirrje në Teuhid; Sureja el-Haxh fillon me mbjelljen e frikës në zemrat e njerëzve nga Dita e Ringjalljes, dhe i paralajmëron ata kundër pasimit të shejtanit; Allahu i përgënjeshtroi ata që mohojnë ringjalljen duke ua bërë me dije vetë krijimin e njeriut dhe ringjalljen e tokës pas shterpëzimit të saj; Historinë se si haxhi iu bë obligim Ibrahimit, dhe disa nga ritet e obligueshme dhe të preferueshme të këtij adhurimi; Muhaxherëve (Sahabeve që u shpërngulen nga Mekeja) u lejohet ta luftojnë tiraninë pasi u dëbuan me dhunë nga shtëpitë e tyre; Shembulli i mizës; Sureja mbaron duke bërë thirrje për në luftë të shenjtë dhe duke na kujtuar që të kapemi fort pas fesë së Allahut.

XHUZI 18

SURET DHE AJETET ~ 23.*El-Mu'minun*, 24.*En-Nur* dhe 25.*El-Furkan* (1- 20)

Sureja e parë e këtij xhuzi është el-Mu'minun (Besimtarët), emër që me të drejtë përmbledh temën e sures. Fillon me përshkrimin e cilësive të besimtarëve dhe tregon ngjarje nga jeta e Pejgamberëve të ndryshëm. Pastaj i hedh poshtë pretendimet e jobesimtarëve dhe mbron Pejgamberin dhe mesazhin e tij. Në mbyllje, Allahu sërish i përshkruan cilësitë e mëtejme të besimtarëve dhe përshkruan Ditën e Fundit dhe lutjen për falje dhe mëshirë. Pason sureja en-Nur (Drita) me ajetin kurorëzues të Dritës (35) – për të cilin Ibn Abbasi thoshte "shëmbëlltyra e dritës së Tij në zemrën e besimtarit". Sureja e fundit në këtë xhuz është el-Furkan (Dalluesi) i cili ndan dritën nga errësira, udhëzimin nga devijimi, të vërtetën nga e kota. Ajo e ngushëllon Pejgamberin, duke e siguruar dhe mbështetur atë në një kohë kur ai po përballej me refuzim, armiqësi dhe keqtrajtim të ashpër nga ata të cilët po i fronte në Islam.

Ç'NA MËSON KY XHUZ?

Cilësitë e besimtarëve tregohen në fillim të sures el-Mu'minun. Pyesni veten se cilat nga këto cilësi i keni? Përshkruhet skenari i vdekjes, rënia e borisë, fundi i atyre që nuk besojnë; Ajetet në fillim të sures el-Mu'minun tregojnë se besimtarët do të jenë të suksesshëm kurse ato në mbarim flasin për dështimin e jobesimtarëve; Sureja en-Nur hapet me ajetet kuranore të cilat flasin për dënimin e caktuar për kurvëri, akuza të rreme, dhe dispozitën e *li'an-it* (betimi i burrit se gruaja e tij ka kryer marrëdhënie jashtëmartesore); Sureja vërteton hyjnisht virtytin e Aishes nga thashethemet e rreme që u përhapen kundër saj; Duhet kërkuar leje para se të hyhet në shtëpi të huaj; Premtimi i Allahut se Ai do t'i bëj mëkëmbës në Tokë ata që besojnë, por besimtarët duhet përmbushur disa kushte; El-Furkan fillon duke lavdëruar Atë që zbriti Dalluesin (që ndanë të mirën nga e keqja); Flitet për akuzat kundër Kur'anit dhe Pejgamberit.

XHUZI 19

SURET DHE AJETET ~ 25.*El-Furkan* (20- fund), 26.*Esh-Shu'ara dhe* 27.*En-Neml* (1- 55)

Duke vazhduar deri në fund me suren el-Furkan, Allahu u drejtohet akuzave të ngritura kundër Kur'anit dhe të Dërguarit dhe i hedh poshtë që të gjitha. Me të vënë në pah mohimet dhe persekutimet e tilla të kahmotshme, Allahu i tregon incidentet nga jeta e Pejgamberëve të mëparshëm që kaluan nëpërmjet sprovave të ngjashme. Si paralajmërim për jobesimtarët, sureja thekson se cili do të jetë fundi i tyre nëse ata vazhdojnë të qëndrojnë në mosbesimin e tyre, kurse në përmbyllje përmendet roli i Pejgamberit dhe përshkruhet besimtari i vërtetë. Në suren vijuese, *esh-Shu'ara* (Poetët), flitet për bazat e besimit: Njëshmëria e Allahut, shpallja e Allahut dhe Dita e Fundit, dhe jepen shembuj të fuqisë dhe begative të Allahut në natyrë. Thelbi i sures i kushtohet ngjarjeve historike, mbretëron një frymë paralajmëruese që përshkon gjithë suren. Sureja e fundit e këtij xhuzi është *en-Neml* (Milingonat) – hapet dhe mbyllet duke e përshkruar Kur'anin si sihariq për besimtarët dhe paralajmërues për të tjerët.

Ç'NA MËSON KY XHUZ?

Shembuj të shkatërrimit të popujve të mëparshëm nga Allahu që shërbejnë si paralajmërim për njerëzimin; Njëshmëria e Allahut dëshmohet nga argumentet e Tij në krijim; Cilësitë e robërve të er-Rahmanit – lexoni me kujdes ato! Një numër tregimesh mbi pejgamberët e mëhershëm që kishin për qëllim ngushëllimin e Pejgamberit Muhamed; Zemër e shëndoshë është ajo zemër e cila delë e suksesshme në Ditën e Gjykimit; Hudi përkujtoi popullin e tij për bekimet e shumta që Allahu u kishte dhënë atyre dhe ua sqaroi mënyrën për të shfaqur mirënjohje ndaj Tij përmes devotshmërisë (*takva*); Ngjarja e Shuajbit ku ilustron udhëzimi pejgamerik për adhurim kushtuar Allahut sikur ta shihnit Atë, ndonëse nuk mund ta shihni Atë, dijeni se Ai ju shehë juve; Kur'ani është udhëzues dhe sihariq për besimtarët; Pa marrë parasysh se sa komploton dhe planifikon për të bërë keq jobesimtari, Allahu është më i miri i planifikuesve.

XHUZI 20

SURET DHE AJETET ~ 27. *En-Neml* (56- fund), 28. *El-Kasas*,
29. *El-Ankebut* (1- 45)

Ky xhuz fillon me mbarimin e sures en-Neml. Në ajetet përmbyllëse kërkohet përsiatje rreth shenjave të Allahut në krijimet e Tij dhe ta pranojmë se disa njerëz që pretendojnë të hyjnizohen janë në fakt tejet të dobët karshi Allahut të Gjithëfuqishëm që i di të gjitha. Sureja mbaron me tema të fuqishme për jetën e përtejme; vdekjen para jetës së ahiretit, fryrjen në bori dhe Ditën e Fundit. Në fund, Pejgamberi urdhërohet t'i nënshtrohet Allahut dhe t'i thrras njerëzit në Kur'an. Në kapitullin vijues, el-Kasas (Tregimet) flitet për Musain – lindjen, rritjen, edukimin, mërgimin, thirrjen, dhe luftën e tij me Faraonin dhe eksodin e mëvonshëm, ngadhënjimin e tij të fundit dhe shkatërrimin e jobesimtarëve. Temë kryesore e kësaj sureje është ajo e luftës, kujdesi i begatë i Allahut dhe fundi i keq i atyre që janë kryeneqë dhe përhapin të keqen. Sureja e fundit e këtij xhuzi është el-Ankebut (Merimanga) që merr emrin nga shëmbëlltyra e ajetit 41 – ku dobësia e idhujtarisë krahasohet me rrjetën e brishtë të merimangës.

Ç'NA MËSON KY XHUZ?

Se njerëzit mund të bëhen aq të prishur saqë urrejnë vetë praninë e atyre që dëshirojnë ta pastrojnë shpirtin e tyre para Allahut; Hedhën poshtë dyshimet e idhujtarëve dhe përshkruhet Dita e Fundit; Allahu i ngushëllon besimtarët e varfër dhe të dobët duke shpallur se e ardhmja është për ta; Ngjarja e Musait se si ai nuk mund ta gjente askë për ta mbështetur atë përveç Allahut. Eh, sa mbështetës i mrekullueshëm që është Ai! Tregimi i Karunit se si u mashtrua nga pasuria e tij; Musai u dëbua me dhunë nga toka e tij, vetëm për t'u kthyer më vonë ngjadhnyeshëm në të, po kjo do t'i ndodhte edhe Muhamedit (paqja qoftë mbi të); Sprovat me të cilat do të ballafaqohen ata që thrrasin në fenë e Allahut: pasuria, shëndeti dhe në përgjithësi jeta e kësaj bote; Ngjarjet e popujve të mëparshëm na paralajmërojnë që kurrë të mos ndihemi aq të sigurtë sa të zhytemi në vetëkënaqësi.

XHUZI 21

SURET DHE AJETET ~ 29. *El-Ankebut* (46- fund), 30. *Er-Rrum*, 31. *Llukman*,
32. *Es-Sexhde*, 33. *El-Ahzab* (1- 30)

Ky xhuz sjell pesë sure të veçanta: përfundimi i sures el-Ankebut (Merimanga), er-Rrum (Romakët), Llukman, es-Sexhde (Sexhdja) dhe fillimi i sures el-Ahzab (Grupacionet). Disa nga ajetet e rëndësishme të këtij xhuz janë që Allahu paralajmëron humbjen e bizantinëve dhe pastaj fitoren e tyre (romakëve), këshillën e Llukmanit që si përmbledhje paraqet kushtet e besimit dhe modelin e sjelljes. Ajetet e sures El-Ahzab merren me aspektet e riorganizimit shoqëror në lidhje me jetën familjare dhe të komunitetit. Edhe pse sureja u është shpallur medinasve, shumica e vendimeve janë mëse relevante për ne sot.

Ç'NA MËSON KY XHUZ?

Urdhërohem të debatojmë me ithtarët e Librit në mënyrën më të mire. Reflektoni gjithashtu në atë se si ne debatojmë me njëri-tjetrin; Humbja e bizantinëve dhe parashikimi se ata do të fitojnë sërish në të ardhmen e afërt – në të vërtetë, Allahu ndihmon kë Ai dëshiron; Dhënia pas kësaj bote është një sëmundje dhe Allahu i qorton idhujtarët, sepse ata ishin të shkujdesur ndaj ahiretit; Thirrja për të përsijatur rreth krijesave të Allahut, ndërrimit të natës dhe ditës, krijimit të njeriut; Shthurja shfaqet si pasojë e asaj që vetë njeriu ka punuar; Llukmani e këshillon të birin – së pari njohja e Teuhidit (Njëshmërisë së Allahut), pastaj trajtimi i mirë i prindërve, qofshin ata edhe jobesimtarë; Cilësitë e besimtarit – cilësitë më të rëndësishme që e shpiejnë njeriun në besim janë durimi dhe bindja e plotë; Gratë e Pejgamberit (paqja qoftë mbi të), të cilat konsiderohen nëna të besimtarëve, pas vdekjes së Pejgamberit, me to nuk lejohej të martohej askush; Beteja e Ahzabit përshkruan gjendjen e besimtarëve dhe hipokritëve, si dhe ashpërsinë e luftës së shenjtë.

XHUZI 22

SURET DHE AJETET ~ 33. *El-Ahzab* (31-fund), 34.*Sebe*, 35. *El-Fatir*, 36.
Ja-Sin (1- 27)

Në këtë xhuz përfundon sureja el-Ahzab (Grupacionet), kurse xhuzi përfundon me ajetet e sures së rëndësishme Ja-Sin. Në fund të sures el-Ahzabit, në pjesën për gratë, Allahu flet për drejtësinë duke dhënë një sekuencë të Ditës së Fundit, më pas përmend besimin që iu është dhënë njeriut. Pas el-Ahzabit vije sureja Sebe me përshkrimet e ca sekuencave të ahiretit ku argumentet e jobesimtarëve dhe përpjekjet e tyre të kota kundër fesë nuk kanë për t'i shpëtuar ata. Sureja gjithashtu flet për mirësitë që Allahu u dha Davudit dhe Sulejmanit që njëherësh inkurajonin Pejgamberin (pagja qoftë mbi të) – Allahu hedh poshtë akuzat ndaj tij dhe jobesimtarët përsëri paralajmërohen për dënimin që i pret. Në suren el-Fatir (Krijuesi) na paraqiten shumë prej Emrave dhe Cilësive të bukura të Allahut, siç është Plotfuqishmëria e Tij, Fuqia e Tij dhe Urtësia e Tij – Ai që i di të gjitha, që është në dijeni për gjithçka, që i shehë të gjitha dhe Ai i cili nuk ka nevoja dhe dëshira. Sureja e fundit e këtij xhuzi, Ja-Sin, fillon me përmendjen e Kur'anit dhe thirrjen e Pejgamberit drejtuar idhujtarëve.

Ç'NA MËSON KY XHUZ?

Flitet për raportet e Pejgamberit me gratë e tij dhe u kërkohet atyre të qëndrojnë në shtëpi; Flitet për cilësitë e shkëlqyera të familjes së Pejgamberit dhe të besimtarëve në përgjithësi; Disa nga rregullat që kanë të bëjnë me divorcin; Hixhabi (mbulesa) e gruas muslimane që është e lidhur me rëndësinë e bindjes ndaj Allahut, siç janë në të vërtetë edhe të gjitha veprat e besimtarëve; Përgënjeshtrimi i idhujtarëve dhe mohuesve të ringjalljes; Udhëzimi i Pejgamberëve për të qenë falendërues ndaj begative të Zotit dhe se sa e sa njerëz janë mosmirënjohës ndaj tyre; Thirrja drejtuar idhujtarëve të reflektojnë për realitetin e Ditës në të cilën vetëm besimi do t'ju sjellë fitim, dhe paralajmërimi se do të jetë tepër vonë për t'u pranuar besimi në atë Ditë! Përkujtim për mëshirën e Allahut dhe begatitë e Tij të mëdha dhe kujdesi ndaj mashtrimit nga shejtani ose dhënies pas kësaj bote; Madhështia e Allahut dhe nevoja e skajshme e njeriut për Të; Planet e liga të idhujtarëve në fund do t'i godasin vetëm ata.

XHUZI 23

SURET DHE AJETET ~ 36. *Ja-Sin* (28-*fund*), 37. *Es-Safat*, 38. *Sad*, 39.

Ez-Zumer (1-31)

Në fund të sures Ja-Sin, Allahu flet për dënimin e popujve të mëparshme dhe thekson përsëri realitetin e ringjalljes. Me një paralajmërim të fuqishëm për gjithë njerëzimin na bëhet mëse e ditur për realitetin e përkohshëm të kësaj bote – “një britmë e tmerrshme... dhe të gjithë, të tubuar, do të paraqiten pranë Nesh.” Xhuzi vazhdon me suren Es-Safat (Të radhiturit), sure që karakterizohet për ajete të shkurta, por të fuqishme. Kjo sure përshkruan melaiket, përgjimin vjedhurazi të xhinve, krijimet e Allahut dhe përgënjeshttrimin e atyre që mohjnë ringjalljen. Sureja mbyllet me falenderimet e panumërta për Allahun. Në suren Sad përsëri na tregohen rrëfimet për të Dërguarit e Allahut që i japin mësim njerëzimit dhe shërbejnë si ngushëllim për Pejgamberin Muhamed – sureja përmban temën e Teuhidit (Njëshmërisë së Allahut), shpalljes dhe llogaridhënies. Sureja e fundit në këtë xhuz, Ez-Zumer (Grupet) i kushtohet pothuajse ekskluzivisht adhurimit që duhet bërë vetëm për Allahun.

Ç'NA MËSON KY XHUZ?

Përshkruhen shenjat e krijimit të Allahut dhe idhujtarët thirren në besim; Njeriu paralajmërohet mos ta adhurojë shejtanin; Vetëm Allahu krijon dhe ringjall; Njëshmëria e Allahut dëshmohet përmes krijimit unik dhe se askush nuk mund të krijojë diçka të ngjashme; Një bisedë mes banorëve të Xhenetit dhe atyre të Xhehenemit duke treguar rrezikun e shoqërisë së keqe; Yt Zot u përgjigjet lutjeve. Pra, a i jeni drejtuar Atij për ndonjë gjë? Pejgamberit i flitet për të Dërguarit që ishin para tij në mënyrë që ai ta kuptoj se si ata ishin përballur me sprova dhe se si kishin bërë durim; Fati i të devotëshme dhe i zullumqarëve; Rrëfimi për shejtanin (Iblisin) që me mendjemadhësi kishte refuzuar t'i përkulej Ademit;

XHUZI 24

SURET DHE AJETET ~ 39. *Ez-Zumer* (32- fund), 40. *Gafir*, 41. *Fussilet* (1- 46)

Xhuzi fillon me fundin e sures ez-Zumer (Grupet). Në ajetet e fundit të kësaj sureje të fuqishme, Allahu përshkruan një skenë të gjallë ku njerëzimi gjykohen të ndarë në dy grupe: besimtarët dhe jobesimtarët. Përfundimi i dy grupeve përshkruhet në hollësi dhe përfundon me një skenë të mahnitshme në të cilën besimtarët hyjnë në portat e Xhenetit ku dëshmojnë melaiket që e rrethojnë Fronin e Allahut. Në këtë vend, besimi i tyre shpërblehet, do t'ju thuhet “ Të gjitha falënderimet i takojnë Allahut, Zotit të Botëve.” Në suren vijuese, Gafir (Falësi), Allahu përshkruan një besimtar që jeton në shtëpinë e Faraonit dhe përpiqet të bindë popullin e tij që të mos kundërshtojë Musain. Në këtë sure përsëriten edhe dy tema: mohimi i së vërtetës dhe thirrja në të vërtetën. Sureja e fundit në këtë xhuz, Fussilet (Dëshmitë e Shtjelluara), vazhdon me temën e sures së mëparshme dhe trajton temat tjera si mendjemadhësia e jobesimtarëve, vërtetësia e Kur'anit, Teuhidi (Njëshmërinë e Allahut) dhe ringjallja.

Ç'NA MËSON KY XHUZ?

Mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut sepse Ai i fal të gjitha mëkatet. Cila palë do të jeni ju në Ditën kur jobesimtarët do të hidhen grupe-grupe në Xhehenem dhe besimtarët grupe-grupe do të dërgohen drejt dyerve të Xhenetit? Përgëzime për ata që pendohen ngase edhe melaiket kërkojnë falje për ta; Dënim i ashpër u është caktuar atyre që mohojnë argumentet e Allahut; Shumë begati nga Allahu; Rreth Kur'anit Fisnik dhe gjendjen e atyre që e mohojnë atë; Rreziku nga shoqëria e keqe dhe se ata mund t'ju tërheqin në mosbesim dhe mëkate; Rëndësia ndaj thirrjes së Allahut dhe sjelljes së mirë; Shikoni përreth horizontet dhe veten tuaj dhe reflektoni mbi shenjat (argumentet) në to. Kjo është mënyra për të gjetur të vërtetën për ata që duan.

XHUZI 25

SURET DHE AJETET ~ 41.*Fusilet (47- fund)*, 42.*Esh-Shura*, 43.*Ez-Zubruf*, 44.*Ed-Duhan*, 45.*El-Xhathije*

Xhuzi i 25-të i Kur'anit fillon me tetë ajetet e fundit të sures Fusilet (Shtjelluar qartë), ku Allahu shpërfaqë dyftyrësinë e njerëzve të cilët kur sprovohen me fatkeqësi i kthehen Krijuesit të tyre me lutje dhe përgjërëm, kurse kur begatohen me të mira nga Allahu, ata largohen prej Tij me kryeneqësi duke thënë: “Këtë e meritoj”. Në suren esh-Shura (Këshillimi) lexojmë për fuqinë, urtësinë dhe vendimin përfundimtar të Allahut, ku sqarohet se këto përbëjnë disa nga bazat e besimit tonë. Realiteti hyjnor që Allahu nuk i ngjan krijimit të Tij është thelbi i kësaj sureje. Dy suret e fundit të këtij xhuzi theksojnë mëshirën, që është Kur'ani, dhe merren me argumentet e ngritura kundër këtij Libri Madhështor. Allahu paralajmëron fatin e atyre që përqeshnin shpalljet e Tij.

Ç'NA MËSON KY XHUZ?

Kur'ani paralajmëron për Ditën e Gjykimit; Allahu zgjedh se kujt Ai dëshiron t'ia zbret shpalljen hyjnore; atëherë ç'është për t'u çuditur që Muhamedi (Paqja qoftë mbi të!) të zgjedhej i Dërguari i Tij? Dëshmitë që tregojnë Njeshmërinë e Allahut; Kur'ani u jep jetë zemrave – vallë a nuk e shihni se sa jetë u është dhënë zemrave tuaja? Statusin e lartë të Kur'anit dhe përgënjeshtrimin e disa prej pretendimeve të idhujtarëve kundër tij; Ndalohej pasimi i verbër i të parëve tanë pa dëshmi të qarta; Allahu ka caktuar furnizimin e njeriut, andaj mos u dëshpëroni duke ngarendur pas bollëkut të kësaj bote; Shoqërimi i vetëm i cili sjell dobi të njëmendët është ai me besimtarët e drejtë; Pasojat e mohimit me kryeneqësi të së vërtetës në këtë botë; Kujdes nga pasimi i epshit ngase njerëzit mund ta marrin epshin e tyre për zot pa e vërjetur fare këtë!

XHUZI 26

SURET DHE AJETET ~ 46.El-Ahkaf, 47.Muhamed, 48.El-Fet'h, 49.El-Huxhurat, 50.Kaf, 51.Edb-Dharijat (1- 30)

Temat e sureve të këtij xhuzi ndryshojnë për faktin se disa nga to iu shpallen Pejgamberit në Mekë, kurse të tjerat sa ishte në Medinë. Suret mekase (el-Ahkaf, Kaf dhe edh-Dharijat) u drejtohen atyre që mohojnë të vërtetën dhe njëherit dëshmojnë ringjalljen dhe Ditën e Gjykimit. Ato inkurajojnë Pejgamberin të vazhdojë thirrjen e tij duke e siguruar atë se ai është në rrugën e vërtetë. Për dallim nga suret mekase, ato medinase (Muhamed, el-Fet'h (Fitorja) dhe el-Huxhurat (Dhomat)) merren me çështje shoqërore dhe aspekte ligjore – me luftën, organizimin e komunitetit musliman, respektin dhe besimin e ndërsjellë mes pjestarëve të komunitetit të sapoformuar musliman. Përmendet tërthorazi në el-Fet'h një ngjarje e rëndësishme historike, traktati i Hudejbijes i ratifikuar nga Pejgamberi dhe arritja e një periudhe paqeje ndërmjet muslimanëve dhe kurejshëve. Pejgamberi sigurohet me anë të shpalljes se traktati qe vërtetë një kthesë e madhe.

Ç'NA MËSON KY XHUZ?

Përsosshmëria dhe preciziteti në krijim është dëshmi se vetëm Krijuesi duhet të adhurohet; Të jemi të butë dhe të dhembshur me prindërit tanë dhe të mos i qortojmë ata; Nuk bën të sigurohemi nga dënimi i Allahut vetëm pse na vijnë bekime të shumta; Për Xhenetin dhe kënaqësitë në të, por edhe për Xhehenemin dhe ndëshkimet atje; Allahu është i kënaqur me ata që u besatuan nën pemë, pandaj keni kujdes, të mos urrehen ata me të cilët Allahu është i kënaqur! Njerëzit janë më të mirë se të tjerët vetëm në devotshmëri (*takva*), kështu që ruhuni nga racizmi dhe partishmëria; Çdo të mirë që besimtari ka është mirësi e dhuruar nga Allahu; Që melaiket regjistrojnë çdo fjalë që themi – a s'do të jesh i kujdesshëm se çka fletë?

XHUZI 27

SURET DHE AJETET ~ 51.*Edb-Dhariat (31-fund)*, 52. *Et-Tur*, 53.*En-Nexhm*,
54.*El-Kamer*, 55.*Er-Rrahman*, 56.*El-Vakija*, 57.*El-Hadid*

Ky xhuz përmban shtatë sure, përfshirë suren melodike dhe të bukur er-Rrahman (I Gjithëmëshirshmi). Në këtë sure, Allahu nxjerr në pah shumë nga bekimet e Tij të kësaj bote, më kryesorja ndër to, Kur'ani madhështor. Allahu gjithashtu përshkruan fundin e botës dhe sjell një pamje madhështore të Xhenetit. Sureja përshkohet me refrenin e vazhdueshëm: "E, cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?", një aluzion dhe qortim për njerëzit dhe xhinët. Suret e tjera të këtij xhuzi prekin tema tipike mekase, siç janë përkujtimi i Ditës së Gjykimit dhe ringjalljes – reflektu dhe merr mësim nga to. Sureja e fundit, el-Hadid (Hekuri) i nxit besimtarët në dy vepra të mëdha: të shpenzojnë në rrugën e Allahut dhe ta mbajnë drejtësinë.

Ç'NA MËSON KY XHUZ?

Që ringjallja dhe shpërblimi vërtetë do të ndodhin; Allahu betohet se furnizimi ynë është në Qiell dhe kjo është po aq e vërtetë sa edhe fjalët që i shqiptojmë me gojët tona – atëherë përse i gjithë ky ankth për furnizimin tuaj? Njeriu dhe xhinët janë krijuar për ta adhuruar Allahun. Ti a s'e adhuron Allahun? Të këmbëngulim me durim në adhurimin e Allahut; Fati i popujve të mëparshëm dhe se idhujtarët hiç s'janë më të mirë se ata; Se Kur'ani është i lehtë për t'u këshilluar me të, por problemi qëndron tek njerëzit – a ka kush që merr mësim? Begatitë e panumërta të Allahut, bekimi i parë është mësimi i Kur'anit. Pyesni veten se sa keni mësuar nga ky Libër? Njerëzimi do të ndahet në tri grupe, dhe ata do të shpërblehen në përputhje me veprat e tyre. Në cilin grup dëshiron të jesh ti? Zemrat duhet të zbuten dhe të mbushen me besim gjatë përkujtimit të Allahut.

XHUZI 28

SURET DHE AJETET ~ 58.*El-Muxhadile*, 59.*El-Hasbr*, 60.*El-Mumtabena*, 61.*Es-Saf*, 62.*El-Xhumua*, 63.*El-Munafikun*, 64.*Et-Tegabun*, 65.*Et-Talak*, 66.*Et-Tabrim*

Xhuzi i 28-të i Kur'anit merret me një sërë çështjesh relevante për komunitetin e sapoformuar musliman të Medinës – komunitet që në fillsat e tij përpiquej të çlirohej nga vargonjtë e idhujtarisë dhe të xhahiljetit (inJORANCËS) duke kërkuar udhëzime nga Kur'ani dhe i Dërguari i Allahut, Muhamedi (paqja qoftë mbi të). Shumë çështje trajtohen në këtë xhuz, megjithatë, ky xhuz njihet ndoshta për tri ajetet e fundit të sures el-Hashr (Dëbimi) ku përmenden mbi 15 Emra ose Cilësi të Allahut.

Ç'NA MËSON KY XHUZ?

Çështjet që kanë të bëjnë me besnikëri dhe armiqësi; Të veproni atë që e thoni; Tregtia e vetme që sjell përfitim të vërtetë është ajo që bëhet me Allahun; Këshillohemi të mos mbërthehemi pas kësaj bote; Allahu është i Plotfuqishëm dhe dija e Tij është gjithëpërfshirëse; Inkurajohemi të kemi devotshmëri (*takva*) dhe të shpenzojmë në rrugën e Allahut; Gratë këshillohen të mos ua bëjnë jetën e vështirë burrave të tyre; Burrat këshillohen që të kujdesen siç është më së miri për familjet e tyre dhe t'i shpëtojnë ato nga zjarri i Xhehenemit.

XHUZI 29

SURET DHE AJETET ~ 67. *El-Mulk*, 68. *El-Kalem*, 69. *El-Hakka*, 70. *El-Mearixh*, 71 *Nuh*, 72. *El-Xhinn*, 73. *El-Muzgemmil*, 74. *El-Muddeththir*, 75. *El-Kijame*, 76. *El-Insan*, 77. *El-Murselat*

Dy xhuzet e fundit të Kur'anit përmbajnë 11, respektivisht 36 sure. Këto sure janë përgjithësisht më të shkurtëra se ato të xhuzeve të mëparshme dhe u shpallen kryesisht gjatë kohës së Pejgamberit në Mekë, në një kohë kur Islami (për arabët idhujtarë) ishte një mesazh i çuditshëm, nënshtrim ndaj një Zoti të padukshëm – kërcënim për të ardhmen dhe prosperitetin e qytetit. S'është aspak për t'u befasuar që suret e këtij xhuzi përqendroheshin në aspektin shpirtëror dhe mëtonin ta forconin besimin në Allahun tek komuniteti i persekutuar. Ato japnin paralajmërime për zjarrin e Xhehenemit dhe Ditën e Kijametit dhe tregonin se si krenaria është një nga mëkatet më të mëdha. Për suren hyrëse, el-Mulk (Sundimi), i Dërguari i Allahut thoshte se ajo do të "ndërmjetësoj për shoqëruesin e saj (domethënë lexuesin e saj) derisa Allahu ta ketë falur atë."

Ç'NA MËSON KY XHUZ?

Disa aspekte të krijimit madhështor të Allahut dhe paralajmërimet për Zjarrin për ata që nuk besojnë; Allahu e lavdëron Pejgamberin për cilësitë e tij të larta; Tmerret e Ditës së Kijametit dhe dhënia e regjistrave (për veprat e mira dhe të liga); Disa nga cilësitë e besimtarëve; Adhurimi i shoqëruar me durim ia mundëson besimtarit të përballet madje edhe me sprovat më të rënda; Rreth Ditës së Kijametit, ngjarjet para, gjatë dhe pas kësaj Dite. E, ç'ke përgatitur ti për atë Ditë? Për ringjalljen dhe shpërblimin – Allahu përsërit dhjetë herë ajetin: "Atë ditë, mjerë ata që përgënjeshtuan!", prandaj kini kujdes, të mos e mohoni kurrë të vërtetën!

XHUZI 30

SURET DHE AJETET ~ 78. *En-Nebe*, 79. *En-Naziat*, 80. *Abese*, 81. *Et-Tekuir*, 82. *El-Infitar*, 83. *El-Mutaffifin*, 84. *El-Inshikak*, 85. *El-Buruxh*, 86. *Et-Tarik*, 87. *El-A'la*, 88. *El-Gashije*, 89. *El-Fexbr*, 90. *El-Beled*, 91. *Esh-Shems*, 92. *El-Lejl*, 93. *Ed-Duba*, 94. *El-Inshirah*, 95. *Et-Tin*, 96. *El-Alak*, 97. *El-Kadr*, 98. *El-Bejjine*, 99. *Ez-Zelzele*, 100. *El-Adijat*, 101. *El-Karia*, 102. *Et-Tekathur*, 103. *El-Asr*, 104. *El-Humeze*, 105. *El-Filë*, 106. *El-Kurejsh*, 107. *El-Maun*, 108. *El-Keuther*, 109. *El-Kafirun*, 110. *En-Nasr*, 111. *El-Mesed*, 112. *El-Iblas*. 113. *El-Felek*, 114. *En-Nas*

Xhuzi i fundit i Kur'anit njihet si Xhuzi Amme, sipas fjalës së tij të parë në ajet dhe përmban 36 suret e fundit të Kur'anit Madhështor. Pasi që këto sure janë të shkurtra dhe kanë ajete përgjithësisht të shkurtra, ky është një xhuz mjaft i njohur për ta filluar mësimin përmendësh të Kur'anit. Ashtu si tek xhuzi i mëparshëm, shumica e këtyre sureve iu shpallën Pejgamberit sa ishte në Mekë. Si të tilla, ajetet e ngushëllojnë Pejgamberin dhe besimtarët me premtime se komuniteti i vogël që ishte në fenë e vërtetë do t'i tejkalonte sprovat e rënda që atyre ua zinin rrugën.

Ç'NA MËSON KY XHUZ?

Ngjarjet e Ditës së Fundit; Aspekte të karakterit të mirë dhe atij të keq; Allahu betohet në krijesat e Tij të ndryshme – reflektoni këto dhe në atë se për çfarë betohet Ai; Të reflektojmë për vetë jetën dhe fundin e njeriut që kjo më pas të na inkurajoj shtimin e veprave të mira dhe pasimin e së vërtetës; Shpallja e parë që iu zbrit Pejgamberit tonë (paqja qoftë mbi të) fillon me urdhrin për të lexuar. E, ku ka libër më të mirë sesa Kur'ani për t'u lexuar? Sureja e parë prej tri sureve të fundit, el-Ihlas (Singeriteti) është sa një e treta e Kur'anit – mendoni mirë pse është kështu duke e lexuar dhe duke e mësuar atë; Të kapemi fort tek Allahu dhe të braktisim gjithçka tjetër, përveç Tij.

Titulli:

Kur'ani, xhuz pas xhuzi

Përkthet:

Visar Zeka

Redaktor fetar:

Fadil Musliu

Prishtinë, 2019